



MT - 500 MATIFIX 2IN1



PAKETIMI

25 kg



RAPORTI I PERZIERJES

6-6.5 L / 25kg



KONSUMI

4-5 kg/m²

Përshkrimi

MT-500 MATIFIX 2IN1 është një ngjitës me bazë çimento për panelet e polisterolit dhe llaç rrafshues për përdorim të përgjithshëm në ambiente të brendshme dhe fasada.

Veçoritë

- I prodhuar posaçërisht për sistemet e termo izolimit dhe ka një fuqi të lartë ngjitëse.
- Ka elasticitet dhe fuqi të lartë lidhëse.
- Përdoret edhe për ngjitje, edhe si llaç rrafshues për suva.
- Është rezistent ndaj kushteve të motit, ujit dhe goditjeve.

Udhëzime për Përdorimin e Produktit (kur përdoret si ngjitës)

- Sipërfaqja duhet të jetë e trajtuar dhe e qëndrueshme. Pastrojeni sipërfaqen nga mbetjet që pengojnë ngjitjen. Pjesët e pasheshuara mbi sipërfaqen ku do të përdoret produkti, duhen trajtuar me llaç riparues MATIART.
- 25kg MT-500 MATIFIX 2IN1 duhen zbrazur me ngadalë në 7.00-7.50L ujë të pastër dhe duhen përzierë derisa të përftohet një masë homogjene pa kokrriza.
- Përzierjen lëreni për 5-10 minuta që të bëhet gati për përdorim dhe përziejeni përsëri para përdorimit.
- Konsumi është 4-5 kg/m².
- Nëse në sipërfaqe ka disnivele, llaçin e përgatitur hapeni në të gjithë pjesën e pasme të panelit të polisterolit; kurse në mes vendosni sërish llaç dhe ngjiteni në mur duke ushtruar forcë.

-Nëse sipërfaqja është e rregullt, atëherë llaçi prapa paneleve mund të aplikohet duke përdorur pjesën e dhëmbëzuar të mallës.

-Gjatë ngjitjes, kontrolloni panelet me mastar ose me nivel uji nëse janë apo jo në të njëjtin nivel.

-Llaçin e përgatitur konsumojeni brenda 3 orëve, ndërsa llaçin që i ka kaluar koha e përdorimit, hidheni poshtë.

-Në varësi të temperaturës së mjedisit dhe karakteristikave të sipërfaqes, veprimin e fiksimit mekanik me upa bëjeni pasi të kenë kaluar të paktën 24 orë.

-Temperatura e zbatimit të produktit dhe kushtet e magazinimit duhet të jenë ndërmjet +5°C dhe +35°C.

Udhëzime për Përdorimin e Produktit (kur përdoret për suva rrafshuese)

-Sipërfaqet e paneleve termoizoluese duhet të jenë pa pluhur dhe të pastra.

-25kg MT-500 MATIFIX 2IN1 duhen zbrazur me ngadalë në 7.00-7.50L ujë të pastër dhe duhen përzierë derisa të përftohet një masë homogjene pa kokrriza. Llaçin lëreni për 5-10 minuta që të bëhet gati për përdorim dhe përziejeni përsëri para përdorimit.

-Konsumi është 4-5 kg/m².

-Llaçin e përgatitur hapeni rregullisht me mallë çeliku mbi panelet termoizoluese. Për të përftuar një trashësi homogjene, gërryejeni suvanë e nivelit të parë me mallë të dhëmbëzuar, me trashësi të dhëmbëve 4x4mm. Rrjetën me fibra xhami shtypeni lehtë dhe futeni në llaç me ndihmën e mallës së çelikut, deri sa suvaja të jetë e njomë.

- Në pikat e bashkimit, pjesët e rrjetës së suvasë vendosini rreth 10cm mbi njëra-tjetrën.
- Pasi dora e parë e suvasë ta ketë lëshuar pak ujin, pa u tharë ende mirë, hidhet suvaja e dorës së dytë.
- Pasi të jetë hedhur dora e dytë e suvasë, sipërfaqja lëmohe me mallë çeliku.
- Llaçin që keni përgatitur, konsumojeni brenda 3 orëve. Llaçi të cilit i ka kaluar koha e përdorimit, duhet hedhur poshtë. Pasi të jetë tharë plotësisht llaçi i suvasë rrafshuese, aplikoni materialin e veshjes së shtresës së fundit me veçori ajruese.
- Temperatura e zbatimit të produktit dhe kushtet e magazinimit duhet të jenë ndërmjet +5°C dhe +35°C.

Jetëgjatësia në Raft

12 muaj në ambient të thatë dhe ambalazh të pahapur.

Magazinimi

Ngjitësi për panelet termoizoluese dhe llaçi për suva MT-500 MATIFIX 2IN1 duhet magazinuar në ambient të thatë dhe thasët të vendosen në stiva e shumta në 10 kate.

SKEDA TEKNIKE (NË +23°C DHE 50% U.R.)

Forma	Pluhur
Ngjyra	Gri/E bardhë
Magazinimi	12 muaj nëse ruhet në paketimin origjinal të mbyllur, në një vend të thatë
Raporti I përzierjes	6-6.5 litra ujë / 25 kg
Temperatura e aplikimit	(+5°C) - (+35°C)
Koha e punueshmërisë	3 Orë
Ngjitja në pllakën termoizoluese	Min. 0.08 N/mm ²
Thithja e ujit	≤ 0.40 kg/m ² dk ^{0.5} W2
Forca përkulëse (EN 1015-11)	Min. 2 N/mm ²
Rezistenca Kompresive (EN 1015-11)	≥ 6 N/mm ² CS IV
Forca e lidhjes - Lloji i thyerjes (EN 1015-12)	≥ 0.5 N/mm ² - B
Dendësia e llaçit të ngurtësuar (EN 1015-10)	1400 ± 100 kg/m ³
Koeficienti i përshkueshmërisë nga avujt e ujit (μ) (EN 1745)	5/20
Përçueshmëri termike (EN 1745)	0.44 W/mK (P=50%)
Shkalla e temperaturës	(-30°C) - (+80°C)
Reagimi ndaj zjarrit	A1
Substanca të rrezikshme	Shiko SDS